



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 121/3 Prot.

Tiranë, më 24/03/2015

Lënda: Dërgohet Vendimi nr. 29, datë 29/03/2015 i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbi ankesën e z. Sokol Ukpëraj, me Nr. 59 rregj., datë 30.06.2014.

Drejtuar: Z.

Adresa: Lagja Nr. 1, Rr. "Kosova", Pall. 10, Krumë, Has.

Z.

Drejtor

Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Kukës.

Adresa: Rruga pranë poliklinikës së qytetit, Kukës.

Bashkëlidhur ju dërgojmë Vendimin nr. 29, datë 29/03/2015, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbi ankesën e z. me Nr. 59 rregj., datë 30.06.2014.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 29, Datë 29/03/2015

Bazuar në pikën 11, të nenit 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:

KONSTATON:

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gjerat "a" dhe "c", dhe pika 3 e këtij neni, nenit 33, pika 10 të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka ndjekur të gjithë hapat që parashikon procedura e hetimit, për të shqyrtuar ankesën nr. 59, datë 30.06.2014, që shtetasi [] ka paraqitur pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, kundër Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Kukës, për diskriminim për shkak të bindjeve politike dhe aftësisë së kufizuar.

Bazuar në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" në fund të procedurës së hetimit ka dalë Vendimi nr. 15, datë 29.01.2015, me anë të të cilit është vendosur: "Konstatimi i diskriminimit të drejtëpërdrejtë të ankuesit z. [], për shkak të bindjeve politike dhe aftësisë së kufizuar, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Kukës". Në pikën 3 të këtij vendimi Komisioneri ka rekomanduar: "Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Kukës, të kthejë në mënyrë të menjëhershme në pozicionin e mëparshëm të punës z. []", si masë konkrete për të eliminuar situatën diskriminuuese. Gjithashtu Komisioneri në pikën 4 të vendimit ka rekomanduar: "Referuar nenit 13, pika 2 e Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga Diskriminimi", ku parashtrohet se: "Punëdhënësi detyrohet të rrisë ndërgjegjësimin për këtë ligj edhe duke e afishuar atë në mjediset publike të vendit të punës, si dhe të mundësojë kuptimin e plotë të tij me mjetet e veta ose me ndihmën e subjekteve të specializuara", Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Kukës, të marrë masat e menjëhershme për zbatimin e kësaj dispozite". Palët e interesuara kanë marrë dijeni për vendimin.

Bazuar në pikën 11, të nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", si dhe në pikën 5, të Vendimit nr. 15, datë 29.01.2015 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Drejtoria



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Kukës, duhet të raportonte, brenda 30 ditëve, para Komisionerit për veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi duke bërë me dije Komisionerin për masat e marra.

Për sa më sipër, Komisioneri arrin në konkluzionin se Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Kukës, është në shkelje të parashikimeve të bëra në pikën 11, të nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", pasi nuk ka zbatuar vendimin nr. 15, datë 29.01.2015 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTË ARSYE :

Bazuar në nenin 32, pika 1, germa "ç", nenin 33, pikat 11,12,13/b e 14 të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

VENDOSI:

1. Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Kukës, të gjobitet me gjobë në vlerën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë.
2. Gjoha të derdhet në Buxhetin e Shtetit brenda 30 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi. Pagesa e kësaj vlere të bëhet pranë çdo banke në llogarinë e thesarit Tiranë, për llogari të: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, NIPT: L02027451K, Kodi: 1091001, Entiteti i Qeverisjes: 1, Distrikti (TDO), Llogaria ekonomike: 7115499.
3. Zbatimi i vendimit nr. 15, datë 29.01.2015 i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi brenda shtatë ditëve nga marrja dijani për sanksionet, sjell shfuqizimin e tyre.
4. Subjekti, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Kukës, duhet të njoftojë Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi në përputhje me sa parashikohet në pikën 3, të këtij vendimi.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi sipas ligjit.

Irma BARAKU

KOMISIONERI



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al